Kjo procedurë të bëhet para aplikimit për leje ndërtimore, në Drejtorinë e Kadastrit të Komunës së Prishtinës, sipas këtyre kushteve ndërtimore dhe me kërkesë të pronari, duke u bazuar edhe në, Plani i situacionit - "zgjidhja urbane" dhe "Situacioni i parcelave me vijën ndërtimore dhe rregulluese nga plani rregullues në sistemin koordinativ KosovaREF01", punuar nga kjo drejtori, dhe Manuali i ndarjes punuar nga gjeodeti i licencuar Driton Haziri nga Prishtina me numër të licencës nr.177, të cilat janë pjesë përbërëse e këtij vendimi për caktimin e kushteve ndërtimore. Kjo procedurë do të realizohet në Drejtorinë e Kadastrit të Komunës së Prishtinës.

**VIII. Këmbimi i pjesës së parcelës kadastrale nr.1794-21 ZK Prishtina**, me pronar / poseduese P.SH. Rrugët - KK Prishtinë, me sipërfaqe S=1567m<sup>2</sup> parashihet me pjesën e parcelës kadastrale, nr.1794-20 ZK Prishtinë me pronar/posedues Bejtush Gashi, gjithë ashtu me sipërfaqe prej S=1567m<sup>2</sup>.

Këmbimi i lartë ceku do të realizohet bazuar në Plani i situacionit – "zgjidhja urbane" e miratuar nga kjo drejtori, manualit të ndarjes punuar nga gjeometri i licencuar, si dhe sipas Ligjit 06/l-092 dt.07.03.2019, për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës.

Andaj, Drejtoria e Urbanizmit jep PËLQIM për këmbimin e pjesëve të parcelave kadastrale të lartcekura, sipas manualit të këmbimit punuar nga gjeometri i licencuar. Procedura e këmbimit do të realizohet bazuar në pëlqimin e konfirmuar në këtë paragraf dhe Manualin e ndarjes punuar nga gjeodeti i licencuar Driton Haziri nga Prishtina me numër të licencës nr.177, të cilat do të shërbejë si bazë për reflektimin në regjistrin kadastral, të këtyre ndryshimeve.

Mos realizmi i kësaj procedura obligon Drejtorinë e Urbanizmit, të anuloi vendimin e kushteve ndërtimore dhe të njëjtin ta rishikoj.

**IX. Bashkimi i pjesëve dhe parcelave kadastrale, nr.1794-19, 1794-20 dhe 1794-21 ZK Prishtinë**, do të realizohet sipas Parcelës ndërtimore, pas realizimit të procedurës së ndarjes dhe këmbimit të përcaktuar në paragrafin VII. dhe VIII. të këtij vendimi, bazuar në Plani i situacionit – "zgjidhja urbane", Situacionit të parcelës ndërtimore me vijën rregulluese dhe ndërtimore nga PRR "Prishtina e Re – Zona Qendër" në Prishtinë, në sistemin koordinativ KOSOVAREF 01 dhe Manuali i bashkimit punuar nga kompania gjeodezike e licencuar.

Andaj, drejtoria jep PËLQIM për bashkimin e parcelave të lartcekura, sipas Planit të situacionit - "zgjidhja urbane" & Situacioni i parcelës ndërtimore me vijën rregulluese dhe ndërtimore nga PRR "Prishtina e Re – Zona Qendër" në Prishtinë, në sistemin koordinativ KOSOVAREF 01 dhe manualit për bashkim.

Procedura e bashkimit do të realizohet pas realizimit të proceduarave të paragrafit VII. & VIII. të vendimit të kushteve ndërtimore dhe bazuar në pëlqimin e përshkruar në këtë paragraf, e cila do të shërbejë si bazë për regjistrimin në operetën kadastrale, të këtyre ndryshimeve.

Bashkimi të realizohet para aplikimit për leje ndërtimore në Drejtorinë e Kadastrit të Komunës së Prishtinës, me kërkesë të pronarit, si dhe bazuar në Situacioni i parcelës ndërtimore me vijën rregulluese dhe ndërtimore nga Plani Rregullues "Prishtina e Re – Zona Qendër" në Prishtinë, në



Driton Haziri nga Prishtina me numër të licencës nr.177, e të cilët janë pjesë përbërëse e këtij vendimi.

**X. Kompensimi / shpronësimi** me sipërfaqe ndërtimore i pjesës së parcelës kadastrale, nr.1794-20 me  $S=748m^2$  e përfshirë në hapësira publike të planifikuara – rrugë & gjelbërim të realizohet si më poshtë:

Me aplikimin e Vendimit 01nr.400-660 dt. 26.05.2008, të Kryetarit të Komunës së Prishtinës për kompensimin e pronës private planifikuar për interes publik me sipërfaqe ndërtimore, sipërfaqja e parcelës jashtë vijës rregulluese - parcelës ndërtimore (deri në 20% ) mund të kompensohet, dhe sipas kalkulimit kjo sipërfaqe e shprehur në përqindje (%) është  $S=2257/3743 \times 100=60.29\%$ , andaj bazuar në vendimin e lartë cekur mund të trajtohet vetëm sipërfaqja prej 20% parcelës ndërtimore, gjegjësisht  $S=3743 \times 0.2=748m^2$ . Andaj, sipërfaqja e lartë cekur e kalkuluar me koeficient ndërtimi, përcakton sipërfaqen ndërtimore të kompensuar prej,  $S=748 \times 3.0 = 2244m^2$ .

Kjo drejtori përmes këtij paragrafi të vendimit të kushteve ndërtimore jep PËLQIM për kompensimin / shpronësimin me sipërfaqe ndërtimore të pjesës së parcelës kadastrale nr.1794-20 ZK Prishtinë me  $S=748m^2$ . Kjo procedurë e kompensimit / shpronësimin me sipërfaqe ndërtimore do të realizohet bazuar në pëlqimin e konfirmuar në këtë paragraf, i cili do të shërbejë si bazë për arritjen e marrëveshjes definitive, në mes të pronarit të parcelës dhe Komunës së Prishtinës, konkretisht Drejtorisë së Pronës të Komunës së Prishtinës.

Trajtimi definitiv i sipërfaqeve për kompensim / shpronësim me sipërfaqe ndërtimore të mirët pas realizimit të procedurës të përshkruar në paragrafin VII. dhe VIII. të dispozitivit të këtij vendimi;

Mos zbatimi i kësaj procedure sipas këtij paragrafit, nga bashkëpronarët & investitori, për arsye të ndryshme, obligon Drejtorinë e Urbanizmit, të rishikojë sipërfaqet ndërtimore të ndërtesës shumë banesore & afariste, të përcaktuara me këtë vendim të kushteve ndërtimore.

**XI. Kycja në infrastrukturë** - për marrjen e pëlqimeve nga KEDS-i dhe KUR "Prishtina" aplikimi do të bëhet nga kjo drejtori. Për aplikim nevojitet prezantimi i dokumentacionit, me përcaktim të vendeve për kycje në rrjetet përkatëse, i dorëzuar veçantë në CD, me përmbajtje si në vijim:

- Emri (prindi) Mbiemri i aplikuesit dhe numri i identifikimit dhe adresa;
- Informatën mbi lokacionin - adresa e saktë e hapësirës ndërtuese;
- Kopjen e planit dhe certifikatën e njësisë kadastrale;
- Planin e situacionit (dispozita urbanistike pjesë përbërëse e kushteve ndërtimore) dhe pamjen në ortofoto të lokacionit me hapësirën ndërtuese;
- Përshkrimin teknik të objektit (destinimi dhe kapaciteti i nevojshëm për energji elektrike dhe ujësjellës).

Kycja në infrastrukturë për ngrohje qendrore të bëhet në rrjetin ekzistues, pas sigurimit paraprak të kushteve detale dhe pëlqimit për kycje nga "Termokos" - Ngrohtorja e Qytetit sh. dhe PTK-ja.

**XII. Dokumentacioni ndërtimor** - projekti kryesor, të hartohet nga ekipi me përgatitje të lartë profesionale dhe me kualifikime përkatëse për secilën fazë të projektit, duke u bazuar në kushtet ndërtimore të caktuara në pikën IV., projekt propozimin e prezantuar, "Udhëzimit Administrativ i MMPH-së Nr.06/2017 për përcaktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimin për kategorinë e I-rë dhe II-të të ndërtimeve", "Rregullores mbi normat minimale teknike për ndërtesat e banimit në bashkëpronësi", të MMPH nr. 0/2016 dt. 04.11.2016, "Udhëzimit Administrativ MMPH-së 08/2017 për Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor", bazuar në UA nr. 33/2007 për kushtet teknike të objekteve ndërtimore për qasjen e personave me aftësi të kufizuara, normave teknike për siguri nga zjarri si dhe normave dhe standardeve tjera për projektim të kësaj kategorie të ndërtesave, dhe të përmbajë:

- Lokacionin e parcelës ndërtimore në kuadër të zonës;
- Situacionin - planin e lokacionit, të gjerë në diametër prej 50m', me ndërtesa ekzistuese dhe ndërtesat e planifikuara, në përpjesë 1:200, 1:500 apo 1:1000;
- Situacionin - planin e lokacionit 1:200 ose 1:500, me dimensione të shënuara, horizontale dhe vertikale-kuota të lartësisë;
- Situacionin - "zgjidhja urbane" në përpjesë 1:200 ose 1:500, me pozicionim të ndërtesave në sistemin koordinativ KosovaREF01, duke përfshi edhe kuotat vertikale të hyrjeve në përdhese, me kuota relative dhe absolute;

projektuarë dhe infrastrukturës rrugore, në sistemin koordinativ KOSOVARREF 01;

- Të gjitha bazat, prerjet dhe dukjet e fasadave, në përpjesë 1:50, për ndërtesat e projektuara, duke përfshi edhe kuotat vertikale të hyrjeve në përdhese dhe etazheve tjera me kuota të shënuara, relative dhe absolute;
- Përshkrimin teknik me paramasë dhe parallogari të punëve ndërtimore dhe ndërtimore - zejtare;
- Detajet e nevojshme në përpjesë 1:5, 1:10 apo 1:20 dhe specifikimin e zdrukthëtarisë me përshkrimin e materialit të dyerve dhe dritareve, në përpjesë 1:50;
- Projektin e organizimit të kompleksit, me rrugë, shtigjë, mobiljarin urban, etj;
- Projektin e strukturës së ndërtimit - llogarinë statike, me përshkrim teknik, pozicionim dhe detaje të nevojshme;
- Projektin e instalimeve elektro – energjetike, me përcaktimin e vendit për kyçje në rrjetin energjetik të qytetit dhe pozicionimin e trafostacionit;
- Projektin e instalimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit, me përcaktimin e vendit për kyçje në rrjetin e qytetit;
- Projektin e instalimeve të makinerisë, me përcaktimin e vendit për kyçje në rrjetin e qytetit;
- Elaborati i "Organizmi dhe masat e sigurisë në vend ndërtim", bazuar në Vendimin 01 nr. 035-174324 dt. 12.07.2016 e Kryetarit të Komunës së Prishtinës;
- Elaboratin e fizikës ndërtimore dhe atë të mbrojtjes nga zhurma;
- Elaboratin gjeomekanik në bazë të analizave në terrenit;

**XIII. Dokumentacioni ndërtimor për Masat e mbrojtëse nga zjarri** të hartohet nga ekipi me përgatitje të lartë profesionale dhe kualifikim përkatës. Me aplikacionin për leje ndërtimore të dorëzohet dokumentacioni i nevojshëm, në dosje të veçantë, i cili përmes aktit përcjellës, do të procedohet nga kjo drejtori në kompetencë të Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit të Komunës së Prishtinës, për sigurimin e "Deklaratë" për Masat e mbrojtjes nga zjarri. Dokumentacioni i përgatitur duhet të përmbajë:

- Planin e mbrojtjes nga zjarri-elaboratin, të hartuar nga kompani apo individ i licencuar,
- Dëshminë mbi pronësinë për parcelën kadastrale/certifikatën e njësisë kadastrale dhe kopjen e planit (kopje);
- Situacionin-planin e lokacionit, të gjerë në diametër prej 50m', me ndërtesa ekzistuese dhe ndërtesat e planifikuara, në përpjesë 1:200, 1:500 apo 1:1000;
- Situacionin-"zgjdhja urbane" në përpjesë 1:200 ose 1:500, me pozicionim të ndërtesave në sistemin koordinativ KosovaREF01, duke përfshi edhe kuotat vertikale të hyrjeve në përdhese, me kuota relative dhe absolute;
- Kushtet ndërtimore, të caktuara nga Drejtoria e Urbanizmit (kopje);
- Certifikatën e regjistrimit të biznesit të investitorit dhe të hartuesit të planit të mbrojtjes nga zjarri.

Dokumentacioni ndërtimor për **Leje Mjedisore Komunale** të hartohet nga ekipi me përgatitje të lartë profesionale dhe kualifikim përkatës, dhe aplikimi të bëhet në Drejtorinë e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, njëkohësisht me aplikimin për leje ndërtimore.

Dokumentacioni i përgatitur duhet të përmbajë:

- Raporti për Leje Mjedisore Komunale, në tre (3)kopje në formë të shkruar dhe një (1) në formë elektronike;
- Certifikatën për regjistrimin e biznesit;
- Certifikatën e njësisë kadastrale dhe kopjen e planit;

Kontratën për shfrytëzimin e parcelës, nëse parcela nuk është pronë e aplikuesit.

**XIV. Marrëveshja për infrastrukturë** – bazuar në nenin 23 të Ligjit Nr.04/L-110 për Ndërtim dhe në nenin 10 dhe 11 të "Rregullore mbi Taksën administrative për dhënien e lejes së ndërtimit dhe Tarifën për rregullimin e infrastrukturës" 01 nr. 434/01-0094474/17 dt. 24.04.2017, obligohet Drejtoria e Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave e Komunës së Prishtinës, të vlerësojë një ngarkesë për të ri-mbursuar koston për krijimin, përmirësimin, zgjerimin apo riparimin e infrastrukturës, dhe të arrijë marrëveshje për infrastrukturë me pronarin / investitorin.

Me aplikacionin për leje ndërtimore të dorëzohet dokumentacioni i nevojshëm, në dosje të veçantë, i cili përmes aktit përcjellës, do të procedohet, nga kjo drejtori, në kompetencë të Drejtorisë së

marrëveshjeje. Dokumentacioni i përgatitur duhet të përmbajë:

- Dëshminë mbi pronësinë për parcelën kadastrale/certifikatën e njësisë kadastrale dhe kopjen e planit (kopje);
- Vendimi për caktimin e kushtet ndërtimore, së bashku me situacionin e miratuar, të lëshuar nga kjo drejtori;
- Certifikatën e regjistrimit të biznesit të kompanisë investuese;
- Kontratën për bashkë investim (nëse është prezantuar në kërkesën për leje ndërtimore);
- Autorizimin për përfaqësim (nëse është prezantuar në kërkesën e lejes ndërtimore);
- Kopjen e letërnjoftimit të kërkuarit/ve (bashkëpronarëve të parcelave & investitorit);

**XV. PAGESA E KOMPENSIMIT PËR NDËRRIMIN E DESTINIMIT TË TOKËS BUJQËSORE** - meqenëse parcelat kadastrale nr.1794-19, 1794-20 & 1794-21 ZK Prishtinë, në bazë të certifikatave të njësisë kadastrale, evidentohen me lloj të shfrytëzimit të parcelës-tokë bujqësore, me klasë të kualitetit "Pemishtë e klasit 2" dhe Infrastrukturë – "Rrugë", paraprakisht kërkohet të bëhet pagesa e kompensimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, konformë nenit 11, 13 & 14 të Ligjit nr. 02/L-26 për Tokën Bujqësore dhe nenit 8, 9 & 14 të Udhëzimit Administrativ të MBPZHR Nr. 41/2006, për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore, që e rregullojnë këtë fushë.

Sipërfaqja e tokës bujqësore, të cilës do t'i ndërrohet destinimi, do të përcaktohet bazuar në sipërfaqen që do të ndërtohet, gjegjësisht parcelës ndërtimore përcaktuar sipas Plani i situacionit – "zgjidhja urbane", dhe e njëjta do të përfshijë sipërfaqen e parcelës ndërtimore, prej  $S=1557 + 619 = 2176m^2$ . Kjo sipërfaqe së bashku edhe me sipërfaqen e parcelës kadastrale nr.1794-21 ZK Prishtinë me destinim "rrugë", do të regjistrohet si tokë ndërtimore, në regjistrin kadastral, pas realizimit të pagesës së kompensimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore,

Ky kompensim - pagesë do të realizohet në Drejtorinë e Kadastrit të Komunës së Prishtinës, në fazën e zhvillimit të procedurës administrative për marrjen e lejes ndërtimore.

**XVI. PAGESA E TAKSËS ADMINISTRATIVE DHE TARIFËS** për dhënien e lejes së ndërtimit, do të realizohet bazuar në "Rregullore mbi Taksën Administrative për dhënien e lejes së ndërtimit dhe Tarifën për rregullimin e infrastrukturës" 01nr.434/01 – 0094474/17 dt.24.04.2017 dhe bazuar në dokumentacionin ndërtimor / projektin kryesor, si pjesë përbërëse e kërkesës për leje ndërtimore. Pagesa e taksës dhe tarifës, sipas këtij paragrafi, do të realizohet sipas afatit kohor të përcaktuar në paragrafin 4 të nenit 16 të UA të MMPH-së Nr.06/2017 dt.23.05.2017, pas marrjes së konfirmimit për pagesë.

Pagesa e taksës administrative do të llogaritet edhe për rrënimin e ndërtimeve ekzistuese në kuadër të parcelës kadastrale, bazuar në gjendjen ekzistuese, incizimin gjeodezik dhe projektin ideor të atyre ndërtimeve, me pagesën e taksës së përcaktuar në pikën 5.9 të nenit 5 të rregullores së lartcekur dhe vendimit për lejimin e rrënimin.

**XVII. Kushti i përcaktuar në paragrafin VIII. / Këmbimi / të vendimit të kushteve ndërtimore**, do të realizohet në bashkë veprim me Drejtorin e Pronë së Komunës së Prishtinës. Pasi në kuadër të parcelës kadastrale nr.1794-21 ZK Prishtinë me pronar / posedues P.SH. Rrugët - KK Prishtinë, shtrihet ndërtesa individuale banimore me etazhitet P+1+Nk me sipërfaqe në bazë  $S=100m^2$ , me N.N. posedues, andaj paraprakisht para këmbimit obligohen poseduesi i vendimit të kushteve ndërtimore në bashkë veprim me Drejtorin për Pronë të Komunës së Prishtinës (njësisë përgjegjëse e Komunës së Prishtinës për prona të komunës) të zgjidhin çështjen e ndërtesës në kuadër të parcelës kadastrale nr.1794-21 ZK Prishtinë, gjegjësisht ta lirojnë parcelën në tjalë.

Mos zbatimi i kësaj procedure-kushti sipas këtij paragrafit, nga pronari në bashkë veprim me Drejtorin e Pronës, për arsye të ndryshme, obligon Drejtorinë e Urbanizmit, të rishikojë vendimin e kushteve ndërtimore, gjegjësisht të njëjtat ti anuloi.

**XVIII. Harmonizimi me vektorët kadastrale të parcelave kadastrale nr.1794-19 dhe 1794-20 ZK Prishtinë**, duket të realizohet para zhvillimit të procedurave të përcaktuara në paragrafët VII., VIII., IX. dhe X. të vendimit të kushteve ndërtimore, gjegjësisht para aplikimit për leje ndërtimi;

**XIX. Vlefshmëria e vendimit të kushteve ndërtimore** është një(1) vit, me mundësi të vazhdimin për një(1) vit tjetër, në rastet kur nuk ka ndërruar gjendja ekzistuese apo dokumenti i planifikimit hapësitor, dhe me aplikim para skadimit të afatit të vlefshmërisë.

Kërkuesi/pronari, Bejtush Gashi nga Prishtina, rr."Bajram Bahtiri"nr.93, me kërkesën 05nr.350/03 – 131425/19 dt.07.06.2019, ka kërkuar nga kjo drejtori rishqyrtimin e Vendimit 05nr.350/02 – 264680/18 dt.29.11.2018, mbi refuzimin e kërkesës 05nr.350/02 – 0264680/18 dt.02.11.2018, për caktimin e kushteve ndërtimore, si dhe ka kërkuar caktimin e kushteve ndërtimore, për hartimin e dokumentacionit ndërtimor / projektin kryesor për ndërtimin e kompleksit me ndërtesë shumë banesore & afariste - Objekti "1", "2", "3" & "4", në lokacionin e përshkruar në paragrafin I. të dispozitiv të vendimit të kushteve ndërtimore.

Me kërkesën, 05nr.350/03 – 131425/19 dt.07.06.2019, për rishqyrtim të vendimit refuzues, kërkesën, 05nr.350/02 – 0264680/18 dt.02.11.2018, për caktimin e kushteve ndërtimore, si dhe gjatë fazës së zhvillimit të procedurës, është prezantuar dokumentacioni dhe provat si në vijim:

- Dëshminë mbi pronësinë: Kopjen e planit dhe Certifikatat e njërive kadastrale për parcelat kadastrale nr. 1794-19 & 1794-20 ZK Prishtinë, lëshuar nga Drejtoria për Kadastër e Komunës së Prishtinës;
- Fotokopja e pa vërtetuar e Vendimit mbi refuzimin e kërkesës 05nr.350/02 – 0264680/18 dt.29.11.2018, lëshuar nga kjo drejtori;
- Shkresës "Dhënia e pëlqimit për pajisje me leje ndërtimi në parcelën P-71914059-01794-20, me sipërfaqe 3178m<sup>2</sup> dhe P71914059-01794-19 me sipërfaqe 2822m<sup>2</sup> ZK Prishtinë të evidentuara në certifikatën me numër të lendes 11-942/03-0154433/18 dt.28.06.2018, lëshuar nga Raiffeisen Bank me seli në Prishtinë;
- Aktin noterial "Autorizim i përgjithshëm" përpiluar te Notare Valbona.Y. Murtezi Bytyqi në Prishtinë, me LRP.Nr.rend.4443/2018 dt.01.11.2018;
- "Informim nga Plani Rregullues Prishtina e Re – Zona Perëndimore" me referencë nr.1936 dt.27.10.2018, të lëshuar nga Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm të Komunës së Prishtinës.
- Situacionin e terrenit në parcelën 1794-19 dhe 1794-20 ZK Prishtinë, punuar nga gjeodeti i licencuar Driton Haziri nga Prishtina me nr. të licencës 177;
- Vërtetimin e obliguesit tatimor në emër të Bejtush Gashi nr.257861/18 dt.25.10.2018;
- Fotokopja e letërnjoftimit të Bejtush Gashi;
- Fotokopja e letërnjoftimit të Florian Shala;
- Akti noterial "Pëlqim", përpiluar te Notare Valbona.Y. Murtezi Bytyqi në Prishtinë, me LRP.Nr.rend.2347/2016 dt.27.07.2016 (kopje);
- Fotot e lokacionit;
- Projekt propozimin konceptual, hartuar nga "LSN ARKITEKT"sh.p.k. nga Prishtina, me projektues Arben Isahu, Lulzim Nuza;
- Afishja "Njoftim Publik" i datës 27.06.2019 gjerë me datë 11.07.2019;
- Manualin e ndarjes dhe bashkimit të parcelave kadastrale nr. 1794-19, 1794-20 dhe 1794-21 ZK Prishtinë, punuar nga gjeodeti i licencuar Driton Haziri nga Prishtina me nr. të licencës 177;
- Fotokopja e pa vërtetuar e Kushteve ndërtimore 05nr.350 – 47943 dt.25.07.2016, të lëshuara nga kjo drejtori në emër të pronarëve, Iljasa Fazliu, Ibrahim Kuka, Mehdi Begolli, Bekim Vokshi, Muharrem, Selatin dhe Skender Morina, Izet, Elez dhe Agron Krasniqi, Alban Gashi, me investitor NTN "Miri"sh.p.k. nga Prizreni, me numër biznesi 70459045, përfaqësuar nga Xhafer Kastrati nga Malisheva;
- Kushtet ndërtimore 05nr.350-47943 dt.25.07.2016, të lëshuara nga kjo drejtori, në emër të pronarëve Iljasa Fazliu, Ibrahim Kuka, Mehdi Begolli, Bekim Vokshi, Muharrem, Selatin dhe Skender Morina, Izet, Elez dhe Agron Krasniqi, Alban Gashi, me investitor NTN "Miri"sh.p.k. nga Prizreni, me numër biznesi 70459045, përfaqësuar nga Xhafer Kastrati nga Malisheva, sipas kërkesës 05nr.350-47943 dt.29.02.2016, kushtet ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor për ndërtimin e kompleksit të objekteve shumë banesore & afariste - "Objekti 1" me Lam."1" dhe "Objekti 2" me Lam" 2" dhe "3" dhe hapësirat përcjellse (si "Faza e parë" e realizimit), në kuadër të nen blloqeve urban "C-2-5" dhe "C-2-7"(ndryshuar dhe ri parceluar) Tërësia "C" të Planit Rregullues "Prishtina e re - Zona perëndim" në Prishtinë, gjegjësisht në kuadër të parcelave kadastrale, nr.1794-3,1794-8,1794-9,1794-10,1794-12, 1794-13,1794-14,1794-15 dhe 1794-16 dhe pjesës së parcelës kadastrale nr.1794-1 (Pasuri shoqërore – KK Prishtinë);

plotësohen "Kushtet ndërtimore 05nr.350-47943 dt.25.07.2016, të pronarëve: Iljasa Fazliu, Ibrahim Kuka, Mehdi Begolli, Bekim Yokshi, Muharrem, Selatin dhe Skender Morina, Izet, Elez dhe Agron Krasniqi, Alban Gashi nga Prishtina dhe investitorit NTN "Min" sh.p.k. nga Prizreni, me numër biznesi 70459045, përfaqësuar nga Xhafer Kastrati nga Malisheva, për hartimin e dokumentacionit ndërtimor për ndërtimin e Kompleksit të objekteve shumë banesore & afariste - "Objekti 1" me Lam."1" dhe "Objekti 2" me Lam." 2" & "3" dhe hapësirat përcjellëse (si "Faza e parë" e realizimit), në kuadër të nënblloqeve urban "C-2-5" dhe "C-2-7"(ndryshuar dhe riparceluar) tërësia "C" të Planit Rregullues "Prishtina e re - zona perëndim" në Prishtinë, gjegjësisht në kuadër të parcelave kadastrale, nr.1794-3,1794-8, 1794-9,1794-10,1794-12, 1794-13,1794-14,1794-15 dhe 1794-16 dhe pjesës së parcelës kadastrale nr. 1794-1 (Pasuri shoqërore – KK Prishtinë).

Drejtorja e Urbanizmit, pas shqyrtimit të kërkesës 05nr.350/03 – 131425/19 dt.07.06.2019, për rishqyrtim të vendimit refuzues, të kërkesës për kushte ndërtimore 05nr.350/02 – 0264680/18 dt.02.11.2018, dokumentacionin e prezantuar me kërkesa si dhe gjatë fazës së zhvillimit të procedurave administrative, konsultimit të rregullativës ligjore në fuqi nga lëmi i planifikimit, ndërtimit dhe procedurës së përgjithshme administrative, dokumentin e planifikimit hapësinor – Plani Rregullues "Prishtina e Re – Zona Perëndim", si dhe konsultimin e dosjet e lëndëve 05nr.350 – 47943 dt.29.02.2016 dhe 05nr.350/02 – 1102/17 dt.11.01.2017, në mënyrë kronologjike dhe procedurale, konstaton se:

Kjo drejtori, pas pranimit të kërkesës për kushte ndërtimore 05nr.350/02 – 0264680/18 dt.02.11.2018, shqyrtimi të sajë kjo drejtori me Vendimin 05nr.350/02 – 0264680/18 dt.29.11.2018, ka refuzuar kërkesën për caktimin e kushteve ndërtimore me arsyetimin dhe konstatimet e poshtë cekur:

Parcelat kadastrale, nr.1794-19 & 1794-20 ZK Prishtinë, bazuar në dokumentet e planifikimit hapësinor, përfshihen në kuadër të Planit Rregullues "Prishtina e Re – Zona Perëndim" në Prishtinë, miratuar me Vendimin e Kuvendit të Komunës së Prishtinës, 01 nr. 35-186850 dt.02.10.2013, konkretisht në kuadër të Blloku urban "C-2" të Tërësisë "C", ku sipas këtij plani kjo zonë është "Zonë mikse e ndërtimit".

Kjo drejtori bazuar në kërkesën 05nr.350 – 47943 dt.29.02.2016 të pronarëve, Iljasa Fazliu, Ibrahim Kuka, Mehdi Begolli, Bekim Yokshi, Muharrem, Selatin dhe Skender Morina, Izet, Elez dhe Agron Krasniqi, Alban Gashi dhe Investitori N.T.N."Min"sh.p.k. nga Prizreni, bazuar në analizat e lokacionit dhe parametrat dhe kriteret urbane të planit rregullues, kjo drejtori ka caktuar Kushtet ndërtimore 05nr.350 – 47943 dt.25.07.2016; në emër të pronarëve dhe investitorit të lartë cekur për parcelat kadastrale, nr.1794-3,1794-8,1794-9,1794-10,1794-12, 1794-13,1794-14,1794-15 dhe 1794-16 dhe pjesës së parcelës kadastrale nr.1794-1 (Pasuri shoqërore – KK Prishtinë), kurse me Konkluzion 05nr.350/02-1102/17 dt.15.02.2017, të njëjtat kushte janë ndryshuar dhe plotësuar, ku në kuadër të Plani i situacionit – "zgjidhja urbane" është trajtuar edhe parcela kadastrale nr.1794-18 ZK Prishtinë, me pronar / posedues Nadije Morina – Kuqi, duke mbetur e njëjtë zgjidhja urbane për "Faza e dytë". Bazuar në Kushtet ndërtimore 05nr.350 – 47943 dt.25.07.2016, të ndryshuara dhe plotësuar me konkluzionin e lartë cekur, konkretisht, paragrafit II. të kushteve, Plani i situacionit – "zgjidhja urbane", është konceptuar në tri faza: "Faza e parë" me trajtim të parcelave kadastrale, nr.1794-3,1794-8,1794-9,1794-10,1794-12, 1794-13,1794-14,1794-15 dhe 1794-16 dhe pjesës së parcelës kadastrale nr.1794-1 (Pasuri shoqërore – KK Prishtinë), si dhe parcelës 1794-18 ZK Matigan; "Faza e dytë" me parcelat nr.1794-19 & 1794-20 ZK Prishtinë, me trajtim përmes këmbimit edhe të pjesës së parcelës, 1794-1 ZK Prishtinë me pronar / posedues P.SH. – KK Prishtinë, me që rast, pjesë e kushteve ndërtimore është bashkangjitur edhe Plani i situacionit – "zgjidhja urbane", me të cilën zgjidhje urbane është pajuar dhe kontribuar edhe pronari i parcelave kadastrale nr.1794-19 & 1794-20 ZK Prishtinë, Bejtush Gashi, përmes, "Pëlqim" të përpiluar dhe vërtetuar të Noteria Valbona Y. Murtezi Bytyqi Lrp.nr.2347/2016 dt.25.07.2016, mbi pajtimin dhe dhënien e pëlqimit për Plani i situacionit - "zgjidhje urbane".

Bazuar në Plani i situacionit – "zgjidhja urbane" për parcelat e lartë cekura, prezantuar nga kërkuesi, dhe hartuar nga kompania projektuese "LSN Arkitekt"sh.p.k. nga Prishtina, konstatohet se zgjidhja e prezantuar nuk korrespondon (nuk është e njëjte) me zgjidhjen urbane të miratuar me Kushtet

dt.25.07.2016, dhe e cila zgjidhje shtrihet edhe jashtë parcelave, nr.1794-19 & 1794-20 ZK Prishtinë, duke mos trajtuar edhe pjesën e parcelës kadastrale nr.1794-1 ZK Prishtinë, me pronar / posedues P.SH. KK Prishtinë, sikur që është konceptuar në propozimin për fazën e dytë sipas kushteve ndërtimore.

Bazuar në evidencën kadastrale për njësinë kadastrale P-71914059-01794-21 ZK Prishtinë (ndryshuar pas ndarjes dhe këmbimit të parcelës bazë P-71914059-01794-1 ZK Prishtinë, me pronar/posedues P.SH. KK Prishtinë), konstatohet se me Aktvendim C.NR.2418/15 DT.06.11.2017, sipas Gjykatës Themelore në Prishtinë, e njëjta ka masë të sigurisë, dhe sipas aktvendimit ndalohej çdo veprimtari deri sa të jepet vendimit tjetër mbi masën e sigurisë, andaj sipas këtij konstatim të gjykatës në kuadër të kësaj parcelo nuk lejohet ndërmarrja e kurrfarë veprimi, andaj deri në pezullimin e kësaj mase kjo drejtori nuk mund të trajtoj kërkesën me te edhe Plani i situacionit - "zgjidhja urbane" për caktimin e kushteve ndërtimore, pasi kjo pjesë e parcelës kadastrale bazuar në kriteret dhe parametrat e planit rregullues dhe Kushtet e ndërtimit 05nr.350 – 47943 dt.25.07.2016, përfshihet në kuadër të bllokut urban "C" të Planit Rregullues "Prishtina e Re - Zona Perëndim" në Prishtinë.

Dhe bazuar në konstatimet e lartë cekura, dhe rregullativës ligjore në fuqi konkretisht nenit 13, paragrafi 4 pika 4.3 të UA të MMPH-së Nr.06/2017 dt.23.05.2017, ka vendos që kërkesën për caktimin e kushteve ndërtimore ta refuzojë.

Kërkuesi / Pronari Bejtush Gashi, pas ndryshimit të rrethanave dhe përmbushjes së kriterëve me të cilat është refuzuar kërkesa e lartë cekur, me kërkesës 05nr.350/03 – 131425/19 dt.07.06.2019, ka kërkuar nga kjo drejtori rishqyrtimin e Vendimit 05nr.350/02 – 0264680/18 dt.29.11.2018 mbi refuzimin e kërkesës për caktimin e kushteve ndërtimore dhe caktimin e kushteve ndërtimore për ndërtimin e kompleksit me ndërtesë shumë banesore & afariste - Objekti "1", "2", "3" & "4", në kuadër të Bllokut urban "C-2" të Tërësisë "C", të Planit Rregullues "Prishtina e Re – Zona Perëndim" në Prishtinë, konkretisht në kuadër të parcelës kadastrale, nr. 1686-1 ZK Prishtinë, me trajtim përmes këmbimit dhe transferimit edhe të parcelës nr.1794-19 dhe 1794-20 ZK Prishtinë, me trajtim edhe përmes këmbimi të me pjesës së parcelës nr.1794-21 ZK Prishtinë, me pronar / poseduese P.SH. Rrugët - KK Prishtinë, sipas projekt propozimit / Plani I situacionit - "zgjidhjes urbane" dhe projektit konceptual të prezantuar.

Drejtorja e Urbanizmit pas pranimit të kërkesës së lartë cekur dhe konstatimit se kanë ndryshuar rrethanat sipas të cilave është refuzuar kërkesa për caktimin e kushteve ndërtimore, dhe duke u bazuar në rregullativën ligjore në fuqi, konkretisht nenit 18 të Ligjit të Ndërtimit nr. 04/L-110 dt. 31.05.2012, nenit 21 të Ligjit për Planifikim Hapësinor Nr.04/L-174 dt.31.07.2013 dhe nenin 13 të "Udhëzimi Administrativ i MMPH-së Nr.06/2017 për përcaktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimi për kategorinë e I-rë dhe II-të të ndërtimeve", me datë 27.06.2019 ka vendosur afishen "Njoftimi publik" e cila ka qëndruar gjer me datë 11.07.2019, ku sipas rregullativës ligjore të lartë cekur para caktimit të kushteve ndërtimore, publiku i rrethinës duhet të informohet me synimin e kërkuesve dhe ofrimin e mundësin për dhënien e komenteve të pronarëve / poseduesve të rrethinës në diametrim e dritës prej 50m', por gjatë kësaj periudhe në adresën e postës elektronike të vendosur në afishe- njoftimit publik nuk ka arritur ndonjë koment.

Drejtorja e Urbanizmit pas pranimit të kërkesës dhe shqyrtimit të dokumentacionit të bashkangjitura në kërkesa, dhe me që rast konstatoi se:

Parcela kadastrale nr.1794-19 dhe 1794-20 ZK Prishtinë janë me sipërfaqe totale prej  $S=6000m^2$ , me pronar Bejtush Gashi, dhe të njëjtat përfshihet në kuadër Bllokut urban "C-2" të Tërësisë "C", të Planit Rregullues "Prishtina e Re – Zona Perëndim" në Prishtinë, ku në kuadër të këtij blloku përfshihet edhe pjesa e parcelës kadastrale e nr.1794-21 ZK Prishtinë, me  $S=1567m^2$  pronar/posedues P.SH. KK Prishtinë, e cila pjesë është trajtuar me Planin e situacionit – "zgjidhjen urbane" dhe është planifikuar të këmbehet me pjesën e parcelës nr.1794-20 ZK Prishtinë me pronar / posedues Bejtush Gashi, gjithë ashtu me sipërfaqe prej  $S=1567m^2$ .

Bazuar në projekt propozimin konceptual dhe Planin e situacionit – "zgjidhjes urbane" të prezantuar, nga parcelat e lartë cekura të pronarit Bejtush Gashi, do të trajtohet sipërfaqja e tyre prej  $S=4491m^2$ (të trajtuara, brenda vijës rregullues, përmes këmbimit dhe me kompensim /

gjegjësisht me trajtim në fazat e ardhshme të planifikimit.

Bazuar në analizën e planit të situacionit të parcelës kadastrale nr.1794-21 ZK Prishtinë, në raport me planin rregullues, konstatohet se në pjesën nga kjo parcelë gjerë të rruga e planifikuar e planit rregullues urban – brenda bllokut urbane, konkretisht drejtimin përfshirës të saj (në gjerësinë e kompleksit ), përfshihet në parcelë ndërtimore e cila pjesë bazuar në "Ligjin nr. 04/L-144 për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës" dhe vlerësimin e organit kompetent do të këmbëhet me parcelë private, dhe e njëjta të trajtohet në ndërtim.

Plani i situacionit – "zgjidhja urbane" e prezantuar është në harmoni me kriteret e planit rregullues dhe korrespondon me Planin e situacionit – "zgjidhjen urbane" dhe Planin e situacionit – "zgjidhjes urbane" të miratuar Kushtet ndërtimore 05nr.350-47943 dt.25.07.2016, të lëshuara nga kjo drejtori, në emër të, pronarëve Iljasa Fazliu, Ibrahim Kuka, Mehdi Begolli, Bekim Vokshi, Muharrem, Selatin dhe Skënder Morina, Izet, Elez dhe Agron Krasniqi, Alban Gashi, me Investitor NTN "Miri"sh.p.k. nga Prizreni, me numër biznesi 70459045, përfaqësuar nga Xhafer Kastrati nga Malisheva, sipas kërkesës 05nr.350-47943 dt.29.02.2016, kushtet ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor për ndërtimin e kompleksit të objekteve shumë banesore & afariste - "Objekti 1" me Lam."1" dhe "Objekti 2" me Lam"2" dhe "3" dhe hapësirat përcjellëse (si "Faza e parë" e realizimit), në kuadër të nën-bloqeve urban "C-2-5" dhe "C-2-7"(ndryshuar dhe ri-parceluar) Tërësia "C" të Planit Rregullues "Prishtina e re - Zona perëndim" në Prishtinë, gjegjësisht në kuadër të parcelave kadastrale, nr.1794-3,1794-8,1794-9,1794-10,1794-12, 1794-13,1794-14,1794-15, 1794-16 dhe pjesës së parcelës kadastrale nr.1794-1 (Pasuri shoqërore – KK Prishtinë), për të cilën zgjidhje urbane ka dhënë pëlqim edhe Bejtush Gashi, përmes aktit noterial "Pëlqim" përpiluar te Notere Valbona. Y. Murtezi Bytyqi në Prishtinë, me LRP.nr.2347/2016 dt.25.07.2016 dhe të cilat kushte ndërtimore bazuar në kërkesën 05nr.350/02 – 1102/17 dt.11.01.2017, janë ndryshuar dhe plotësuar si dhe është pranuar pala në procedurë, përmes Konkluzionit 05nr.350/02 – 1102/17 dt.15.02.2017;

Në analizën e situacionit nga aspekti i komunikacionit dhe prezantuar në shkresën e zyrtarit – ekspertit për komunikacion, janë përcaktuar masat që duhet të ndërmerren, për kycje të kompleksit me rrugën e brendshme të bllokut, në rrugët e planifikuara të planit rregullues "Prishtina e Re – Zona Perëndim" në Prishtinës, ku ndër të tjera konstatohet :

*Pas shqimit të propozimit të situacionit të zgjidhjes urbane të Bejtush Gashi, në lagjen Prishtina e re, zona perëndim, Prishtinë lidhur me kërkesën për kushte ndërtimore të lëndës 05-350/02-0264680/18 dt.02.11.2018, dhe situacionit të zgjidhjes urbane sipas Konkluzionit 05Nr.350/02-1102/17 dt. 15.02.2017, kycja për automjete në rrugë të planifikuar të paraparë me këtë zgjidhje dhe zgjidhjen e aprovuar sipas konkluzionit 05Nr.350/02-1102/17 dt. 15.02.2017 për ndërtesat, objekti 1 me etazhitet 2B+S+P+11, objekti 2 me etazhitet 2B+S+P+10, objekti 3 me etazhitet 2B+S+P+10, në lagjen Prishtina e re, zona perëndim, Prishtinë, mund të pranohet si e tillë, marr parasysh shmangien e kycjës në raport me udhëkryqet e rrugëve të planifikuara dhe hapësirën e kësaj zgjidhje. Në fazat e ardhshme të projektimit dhe realizimit të ndërtesave banesore me afarizëm për rampa dhe vend parkime, duhet të aplikohen kriteret sipas "Rregullores për Normat Teknike për Ndërtesat e Banimit në Bashkëpronësi", dhe të arrihen kushtet e shikueshmërisë horizontale dhe vertikale në lokacionin e kycjes. Gjerësia e rrugës kaluese me qarkullim dy kahor përgjatë hapësirave të vend parkimeve të jashtme dhe të brendshme në garazha, duhet të jetë minimum 5.5m. Ndryshime në rrugë të planifikuar sa i përket regjimit të trafikut me qëllim të favorizimit të ndërtesave banimore afariste nuk duhet të ketë. Kycja duhet të harmonizohet dhe të përshtatet me profilin e rrugës së planifikuar edhe në kohën kur realizohet ajo.*

Andaj si konkludim përfundimtar, bazuar në konstatimet e më sipërme, dokumentacionin e prezantuar dhe shqyrtuar, konsultimin e rregullativës ligjore në fuqi, konkretisht nenit 21 të Ligjit për Planifikim Hapësinor Nr. 04/L-174 dt. 31.07.2013, nenit 18 të Ligjit për Ndërtim Nr. 04/L-110 dt.31.05.2012, nenit 13 të "Udhëzimi Administrativ i MMPH-së Nr.06/2017 dt.23.05.2017 për përcaktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimi për kategorinë e I-rë dhe II-të të ndërtimeve", si dhe diskercionin për vendose të çështjeve të planifikimit dhe ndërtimit në bazë të nenit 21, 44, 57 & 140 të LPPA-së

e Urbanizmit vendosi që ta miratoj kërkesën për rishqyrtimin e kërkesës për kushte ndërtimore dhe Vendimin 05nr.350/02 – 264680/18 dt.29.11.2018, ta shfuqizoj, dhe kërkesën për kushte ndërtimore me faktet – provat e prezantuar ta trajtoj sipas rregullativës ligjore në fuqi, me që rast të konstatoj se kërkuessit kanë prezantuar të gjithë dokumentacionin e nevojshëm, se plani i situacionit-"zgjidhja urbane", është në harmoni me destinimin dhe kriteret tjera të planit rregullues urban për atë hapësirë, si dhe në harmoni me rrethinën, andaj konstatohet se janë plotësuar të gjitha kriteret e parapara ligjore për caktimin e këtyre kushteve ndërtimore.

Nga sa u cek më lartë u vendos si në dispozitiv të vendimit të kushteve ndërtimore.

**Shtojcë:** Plani i situacioni - "zgjidhja urbane" e kompleksit me ndërtesa të planifikuara dhe hapësirat përcjellëse; Situacioni i parcelave kadastrale në raport me rrugët e planifikuara, si dhe vijën ndërtimore & rregulluese nga Planit Rregullues "Prishtina e Re – Zona Perëndim" në Prishtinë, në sistemin koordinativ KosovaREF 01; Manuali i ndarjes dhe bashkimit të parcelave kadastrale nr.1684-4 & 1686-1 ZK Prishtinë dhe 1668-4 ZK Çagllavicë.

**Udhëzim juridik:** Pala e pakënaqur me vendimin e kushteve ndërtimore, me ankesë mund ti drejtohet kësaj drejtorie brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të këtyre kushteve ndërtimore. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror – MMPH-ja.

**I dërgohet:** Kërkuessve, Qendrës për shërbim me qytetarë, kësaj drejtorie dhe në dosje të lëndës, 05nr.350/02 – 0264680/18 dt.02.11.2018 dhe 05nr.350/03 – 131425/19 dt.07.06.2019.

**I dërgohet përmes postës elektronike:** Drejtorisë për Pronën, Drejtorisë për Kadastër, Drejtorisë për Investime Kapitale dhe Menaxhim të Kontratave, Drejtorisë për Planifikim Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm.

**DREJTORIA E URBANIZMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS,  
05 NR.350/02 – 0264680/18 DT. 29.08.2019**

Zyrtari:  
Ergyn Hajredini



U.D. Udhëheqëse e Sektorit:  
Mimoza Berisha Prestreshi







Republika e Kosovës  
Republica Kosovo-Republic of Kosovo  
*Qeveria - Vlada - Government*

MINISTRIA E EKONOMISË DHE AMBIENTIT / MINISTARSTVO EKONOMIJE I ŽIVOTNE SREDINE / MINISTRY OF ECONOMY AND ENVIRONMENT  
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-71914059-01794-21

Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number: 011-942/03-006404/21  
Data dhe koha e lëshimit / Datum i vrene izdavanja / Date and time of submission: 14.01.2021 - 10:28  
Komuna / Opština / Municipality: Prishtinë / Pristina / Prishtine  
Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: PRISHTINE PRISTINA PRISHTINE  
